



Planuar / Dorezuar Primijsen/Prodato Received/Delivery	24.06.2022	2	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojta Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKRIPSHICK	3696/2022		1/4



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.469/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.469/2022 të datës 19.05.2022 të parashtruar nga ankuesi [redacted] me adresë [redacted] kundër përgjigjes me Nr. 01-120/01-12079 të datës 16.05.2022 nga Menaxheri i Burimeve Njerëzore të Komunës së Gjakovës, në çështjen juridike "Kërkesë nga Marrëdhënia e Punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 24.06.2022, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.469/2022 e datës 19.05.2022 e parashtruar nga ankuesi [redacted]

A r s y e t i m

Ankuesi [redacted] i punësuar në Komunën e Gjakovës, më datë 17.05.2022 përmes postës ka parashtruar ankesë për Këshillin e pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila më datë 19.05.2022 është pranuar nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe është regjistruar me Nr.Prot: 2923/2022, kundër përgjigjes Nr. reference 01-120/01-12079 të datës 16.05.2022 të Menaxherit të Burimeve Njerëzore të Komunës së Gjakovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave, më datë 27.05.2022, ankesën e ankuesit e ka dërguar për përgjigje në ankesë Komuna e Gjakovës, ndërsa me datën 03.06.2022 me numër protokollit 3240/2022, Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Gjakovës, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën A.nr.469/2022 e datës 19.05.2022 me numër protokollit 2923/2022 drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesë për rritje të harmonizimit të koeficientit me nr. 01-120/01-12079 e datës 13.05.2022; Përgjigje në kërkesën numër 01-120/01-12079 nga Menaxheri i Personelit në Komunën e Gjakovës i datës 16.05.2022; Akt Emërim i L.S. me nr.01-112/01-37801 i datës 16.12.2021; Akt Emërim i D.Rr. me nr.01-112/02-18220 i datës 15.07.2021; Akt Emërim i T.V. me nr.01-112/02-37391 i datës 13.12.2021; Akt Emërim i F.G. me nr.01-112/01-37322 i datës 13.12.2021; Akt Emërim i G.N. me nr. 01-112/01-21709 i datës 16.08.2021; Akt Emërim i B.Q. me nr.01-112/02-37479 i datës 14.12.2021; Vendim me nr. 01-112/02-35987 i datës 30.11.2021; Vendim i KPMSHCK A.nr.217/2022 me nr. protokollit 2312/2022 i datës 21.04.2022; Pliko me nr. R 2327999 i datës 17.05.2022; Kërkesë për përgjigje në ankesë me nr. protokollit 3074/2022 e datës 27.05.2022; Përgjigje në ankesë me nr. protokollit 3240/2022 e datës 03.06.2022; Përshkrimi i Detyrave të Punës i datës 16.09.2014; Fletëdorëzimi me nr. 01-120-01-12079; Pliko me nr. R2329878 i datës 01.06.2022;

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankuesit, *është e pabazuar, sepse:*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të administrimit të provave, ka konstatuar se ankuesi është i punësuar sipas Akt Emërimit me Nr.01-112/01-37801 të datës 16.12.2021 në pozitën "Udhëheqës i Sektorit për Transport dhe Trafik" në Drejtorinë për Shërbime Publike në komunën e Gjakovës. I njëjti ka bërë kërkesë për harmonizim të koeficientit në Njësinë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore me pretendimin se është klasifikuar në pozitën Drejtues i Ulët 2 me koeficient 8.0 ndërsa kolegët e tij nga i njëjti institucion kanë klasifikim të njëjtë me të pra Drejtues të Ulët 2 ndërsa kanë koeficient 8.5.

Më datë 16.05.2022 Menaxheri i Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjakovës i është përgjigjur ankuesit lidhur me kërkesën e tij duke, duke e arsyetuar që koha kur ankuesi është rekrutuar ka qenë në fuqi Ligji Nr.03/L-049 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe sipas nenit 34 paragrafi 3 të Rregullores Nr.05/2012 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbim Civil, institucionet e Republikës së Kosovës kanë qenë të detyruara të bëjnë klasifikimin, harmonizimin dhe standardizimin e pozitave në pajtim me dispozitat e kësaj rregulloreje e që një gjë e tillë nuk ka ndodhur në Komunën e Gjakovës veçanërisht tek pjesa e harmonizimit të pagave dhe se e kemi të pamundur të aprovojmë kërkesën tuaj.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër përgjigjes me Nr. reference 01-120/01-12079 të datës 16.05.2022 të Menaxherit të Burimeve Njerëzore të Komunës së Gjakovës, pretendon që t'i bëhet harmonizimin i koeficientit nga tetë (8) në tetë pikë pesë (8.5), sikurse që ka ndodhur në komunaet e tjera.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, lidhur me vendosjen e kësaj çështje juridike-administrative, ka analizuar bazën ligjore konkretisht duke ju referuar dispozitave 19 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, është përcaktuar se: "Zyrtari publik ka të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer, si dhe shtesa të përcaktuara me Ligjin e Pagave", ndërsa nenin 3 paragrafi 1 Ligji Nr.

03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, i cili përcakton se: "E drejta e nëpunësve civilë për pagë të drejtë dhe të rregullt është e garantuar në bazë të kushteve të përcaktuara me këtë ligj dhe me Ligjin e Shërbimit Civil", po ashtu kemi analizuar dispozitat e nenit 9 paragrafi 1 Ligji Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, i cili përcakton se: "Nëpunësit civilë kanë të drejtë të marrin pagën bazë për numrin e orëve të përcaktuara me aktin e kontratës së punës", rrjedhimisht mbi bazë të kësaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se e drejta në pagë është e drejtë themelore nga marrëdhënia e punës dhe nëpunësi civil gëzon të drejtën e realizimit të pagës të përcaktuar në aktin e themelimit të marrëdhënies së punës, si rrjedhojë duke i'u referuar provave të lëndës, konstatohet që ankuesi realizon pagë të përcaktuar sipas aktit të themelimit të marrëdhënies së punës gjegjësisht sipas Akt Emërimit me nr.01-112/01-37801 të datës 16.12.2021 me koeficient tetë (8).

Nga shqyrtimi i të gjitha provave të lëndës, Kolegji nuk ka gjetur ndonjë kontratë apo akt tjetër administrativ të organit të punësimit për harmonizim të koeficientit të ankuesit po ashtu nuk ka gjetur ndonjë veprim juridik që organi i punësuar të ketë ndërmarr lidhur me çështjen e ankuesit, sepse për të realizuar ngritjen apo harmonizimin e koeficientëve *Udhëheqësit e institucioneve të administratës publike ia propozojnë gradat e pozitive në institucionin e tyre ministrisë përgjegjëse për administratë publike, në bazë të rekomandimeve të personit përgjegjës për burime njerëzore në institucionin e tyre, i cili është përgjegjës për zbatimin e standardeve dhe procedurave për klasifikimin e vendeve të punës në Shërbimin Civil. Grada për secilin pozicion të punës dhe ndryshimet, miratohen nga Qeveria, me propozim të institucionit përkatës dhe aprovimit paraprak të ministrisë përgjegjëse për administratën publike dhe ministrisë përgjegjëse për financat, siç parashihet me nenin 7 të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil. Andaj çdo ndryshim në këtë rast duhet të jetë i miratuar nga ministria përgjegjëse për administratë publike dhe ministria përgjegjëse për financa, ndërsa në rastin konkret të ankuesit përveç që nuk kemi ndërmarrje të veprimeve nga autoriteti punëdhënës nuk kemi miratim nga ministritë gjegjëse.*

Nga të lartcekurat, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se përderisa nuk kemi veprime sipas dispozitave të lartcekura, ankuesi do të realizoj pagë sipas aktit të themelimit të marrëdhënies së punës konkretisht akt emërimit dhe në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, kështu që pretendimet ankimore të ankuesit janë të pabazuara.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.469/2022

Avdyll BEKTESHI

Procesmbajtës

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Gjakovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjakovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së